

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**BEYOND MARKETING**

Sot, më datë 03.09.2020, personalisht:

- **Dritan KASA**, i biri i Ndue-s, i datëlindjes 01.10.1993, shtetas shqiptar, lindur ne Puke dhe banues ne Rr.Thoma Filipeu,Pallati Gjoka, Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare BEYOND MARKETING Sh.p.k.

Përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare **BEYOND MARKETING sh.p.k**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojë Shoqërinë Tregtare BEYOND MARKETING SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri BEYOND MARKETING SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit BEYOND MARKETING SH.P.K dhe me emrin tregtar BEYOND MARKETING. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Shërbime në sektorin e telekomunikacionit nëpërmjet telefonit për llogari të vet apo të tretëve duke përfshirë por pa u limituar në marketing, telemarketing, sekretari tefefonike, shitje nëpërmjet telefonit, sondazhe, mesazhe promocionale dhe çdo lloj tjetër aktiviteti apo konsulence të lidhur me to.

Shërbime ndërmjetësimi biznesi, kërkim dhe studim tregu nëpërmjet shërbimit telefonik ose fizikisht në terren.



## **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake Nr.9, Rruga Bardhok BIBA, Nr.4, kati i dyte, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

## **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar eshte 100.000 ( njeqind mije ) Lek dhe zotërohet nga ortaku themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Numri i pjeseve: 1

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku i vetem themelues.

## **NENI 7**

Ortaku i vetem themelues i Shoqërisë Tregtare “BEYOND MARKETING” Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Dritan KASA : pjesemarrja ne perqindje 100 %, 1 kuotë, numri i pjeseve 1, lloji i kontributit ne para, 100.000 ( njeqindmije ) Leke.

## **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Ortaku i Vetem – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Dritan Ndue KASA**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Oratku mund të vendose me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.



#### **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduetojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**Dritan KASA**

*Dritan Kasa*

